REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I MJEDISIT, BUJQESISE, VETERINARISE, PYJEVE, MANAXHIMIT TE UJRAVE, MBROJTJES SE KONSUMATORIT DHE TRANSPARENCES

# RAPORT VENDIMARRJE

Nr. 2 Datë 26/ 05/ 2025

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt-vendimit nr....... datë, ......../......../2025 "Miratimi i Planit Vendor te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve te Ngurta Urbane (PVMIMNU) 2025-2030" dhe "Miratimi i Rregullores te Administrimit te Sherbimit te Mbetjeve"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Elbasan

Hyrje

*Ky projekt-vendim paraqitet nga Drejtoria e Monitorimit, dhe ka për qëllim:*

| | |
|---|---|
| BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI | *Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Vet-qeverisjes vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga Ligji i ri nr.10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i amenduar, në nenin 12, pika 2 citohet: "Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 16 të këtij ligji"*<br>*Ligji 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" date 17.12.2015, i ndryshuar, Rregullores së Pergjithshme te Këshillit Bashkiak dhe Rregullores së Konsultimit Publik. Ky projekt-vendim bazohet në nenin 54 të ligjit 139/20215, pika "k". Votimi që kërkohet është me shumicë thjeshte me 50+1.* |
| SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT | *Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" dhe ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 PVMIMNU eshte instrumenti kryesor i planifikimit per përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifike, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisorë, në lidhje me drejtimet që do të ndërmarrë bashkia në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Këto objektiva specifikë reflektojnë orietimet e politikës kombëtare drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të bashkisë. Mbi bazën e objektivave specifikë të dakordësuar në të gjitha nivelet vendimarrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon skenarët e mundshëm të organizimit të shërbimit të shoqëruar me koston përkatëse dhe politikën fiskale që duhet të ndjekë bashkia në mbulimin e plotë të kostos. PVMIMNU* |

| | |
|---|---|
| | perfundon me nje plan veprimi konkret te ndare ne afate kohore, brenda nje 5 vjeçari, sipas pergjegjesive perkatese te aktoreve te perfshire ne zbatimin e planit. |
| SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet) | PVMIMNU eshte nje objektiv paresor i Bashkise Elbasan. Ne territorin e Bashkise gjenden burime te rendesishme natyrore te cilat kane statusin e zonave te mbrojtura. Zhvillimi i turizmit dhe ekonomise se gjelber perbejne potenciale te rendesishme per permiresimin e nivelit te jeteses se qytetareve te Elbasanit. Keto veprimtari do te zhvillohen duke ruajtur e konsoliduar burimet natyrore nepermjet nje mjedisi te paster dhe shfrytezim racional te tyre.<br>Nepermjet PVMIMNU 2025-20230, bashkia synon te grumbulloje mbetjet ne 100 perqind te tertritorit te saj dhe do te permbushe te gjitha detyrimet per reduktimin deri ne 50 perqind te mbetjeve nepermjet riciklimit dhe kompostimit te mbetjeve te gjelberta, si dhe do te arrije te gjitha objektivat kombetare dhe kriteret e procesit te itegrimit Europian.<br>Tarifimi per sherbimin e pastrimit per qyetaret, biznese private, organizat publike dhe jo publike do te behet ne zbatim te ligjit 139/2015, "Ndotesi paguan".<br>Ne PVMIMNU 2025-2030, synohet mbulimi 100 perqind i kostove te sherbimit me te ardhuar qe do te mblidhen nga tarifat e subjekteve te cileve i sigurohet sherbimi i pastrimit. |
| DREJTORIA PËRGJEGJËSE | Drejtoria e Monitorimit |
| RAPORTIMI DHE MONITORIMI | Raportimi do te realizohet çdo fund viti per zbatimin e Planit dhe paraqitet çdo fund Janari ne Keshillin Bashkiak. |
| IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN | Plani është shtrirë ne zonen urbane - qytetin Elbasan, dhe ne zonat rurale - Njesite Administrative te Bashkise, dhe planifikohet te mbuloje te gjith territorin e Bashkise Elbasan. |
| KONSULTIMI PUBLIK | Ky projekt vendim kërkon konsultim publik sipas nenit 17 te ligjit 139/2015, të Rregullores së Këshillit Bashkiak. Eshte marre vendimi i Kryesise per kalimin ne konsultim publik te projektaktit. Eshte hartuar dhe publikuar ne faqen e internetit te Bashkise Elbasan, njoftimi dhe kalendari per degjasat publike. Jane realizuar gjithsej 2 degjesa me publikun, nje ne qytetin Elbasan/Salla Multifunksionale, Bashkia Elbasan, |

| | |
|---|---|
| | *date 16 prill 2025, dhe nje degjese ne Njesine Administrative Shushice, date 17 prill 2025, ne te cilat kane marre pjese ne total 61 qytetare/banore. Jane mbajtur proces-verbalet e takimeve dhe kane dale rekomandimet per konsultimin publik te cilat jane permbledhur dhe i jane derguar Kryetarit te Bashkise per reflektim.* |

Komisioni i Përhershëm i Mjedisit, Bujqesise, Veterinarise, Pyjeve, Menaxhimit te Ujrave, Mbrojtjes se Konsumatorit dhe Transparences, i mbledhur më datën 26/ 05/ 2025 pasi shqyrtoi Projekt-vendimin për miratimin e Projekt Aktit "Miratimi i Planit Vendor te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve te Ngurta Urbane 2025-2030, Miratimi i Rregullores te Adminsitrimit te Sherbimit te Mbetjeve", relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak:

a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.
b. **<u>Miratimin e projektakteve</u>**
c. Refuzimin e miratimit të Projektaktit
d. Ti kerkoje drejtorise perkatese informacion shtese per projektvendimin
e. Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
   - Pika ...... e projektvendimit të ndryshojë në "___________"
   - Pika ........ e projektvendimit të ndryshojë në"____________"
   - Tabela ...... e projektvendimit të ndryhsojë në"__________"
   - Paragrafi ......... i projektvendimit të ndryshojë në "______"

Bashkëlidhur argumentat e Vendimarrjes dhe mendimi i pakicës i parqitur në procesverbalin e Komisionit

| | |
|---|---|
| Kryetari i Komisionit: | Indrit Abdiaj |
| Nenkryetare e Komisionit: | Mimoza Trimi |
| Sekretar i Komisionit: | Shpetim Llapushi |
| Anetar i Komisionit: | Daniela Sula |
| Anetar i Komisionit: | Jemin Tata |
| Anetar i Komisionit: | Naim Meta |
| Anetar i Komisionit: | Amarda Murati |

Elbasan, më: 26/ 05/ 2025